



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislaturë III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 21. 07. 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Naim Rustemi, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Mungoi: Hajredin Hyseni - ishte i zënë me punë zyrtare.

Të ftuar: Bajram Azemi - nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Elita Vokshi dhe Petrit Hysaj – OSBE, Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Fidan Sylejmani – media: TV Rrokum.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinador, zyrtar i lartë dhe Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

Kryetari konstatoi se *ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë*

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Takimi i Komisionit me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për zbatimin e vendimeve të plotfuqishme,
3. Shqyrtimi i ankesave (peticioneve),
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

1. Takimi me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për zbatimin e vendimeve të plotfuqishme

Kryetari- I përshëndeti përfaqësuesit e KPMK- së , ata që mbikëqyrin punën e Komisionit dhe i njoftoi se është një numër i madh i ankesave, që i vijnë këtij komisioni nga shërbyesit civilë, e që kryesisht kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të KPMK-së, si të plotfuqishme. Në vazhdim kërkoi nga përfaqësuesit e KPMK-së se cilat janë sfidat dhe cilat institucione nuk i zbatojnë vendimet e këtij këshilli dhe çka mund të bëjmë ne si Komision për zbatimin e vendimeve që i nxjerr ky këshill. Prandaj e ftoi Bajram Azemin ta merrte fjalën.

Bajram Azemi – Në vija të trasha e njoftoi Komisionin për funksionimin e Këshillit dhe tha: Këshilli funksionin e vet e kryen në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 për shërbimin civil të Kosovës. Në vazhdim e paraqiti raportin për periudhën 1 janar 2009 deri më 30 qershor 2009, në të cilin shihet se gjatë kësaj periudhe kishte pranuar 140 ankesa. Prej tyre 13 për mosvazhdimin e kontratave të punës, 34 për ndërprerje të kontratës së punës, 42 për konstatim të konkursit, 27 për kompensim të pagave, 4 për masa disiplinore, 3 për suspendim, 16 për degradim dhe 1 për vlerësim joobjektiv. Pastaj ofroi të dhëna për përkatësinë kombëtare të ankuesve, duke u ofruar paraqitje tabelore të ankesave të vendosura sipas gjinisë dhe nacionalitetit.

Ibrahim Makolli – Pyeti se çka na duhet një institucion i tillë ,nëse vendimet e tij nuk zbatohen.? A është ky një mashtrim i madh që u bëhet nëpunësve civilë? Dhe tha se KPMK-ja është dashur t'i dërgonte raport Kuvendit të Kosovës, sepse kështu është e detyruar me ligj. Kërkoi nga Këshilli që Kuvendit t'i procedohet Raporti duke kërkuar të identifikohen se cilat institucione nuk i zbatojnë këto vendime.

Sanije Alijaj – Praninë e përfaqësuesve të KPMK-së e cilësoi formë të mirë të komunikimit, me qëllim që të mbrohet e drejta e shërbyesve civilë nga marrëdhënia e punës, që po shkelet vazhdimisht, siç po shkelet edhe Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm, si nga ministria ashtu edhe nga drejtoritë përkatëse. Ajo kërkoi që puna e Këshillit të jetë më publike për të pasur efekt pozitiv.

Drita Maliqi – Duke u ndërlidhur me të dhënat e raportit të KPMK-së ceku se në rajonin e Gjilanit është një numër më i madh ankesave drejtuar Këshillit për realizimin e të drejtave të tyre. Si shembull ceku Ymer Selimin, të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Danush Ademi -duke u ndërlidhur me parafafolësit e ngriti çështjen e mos pagimit të 20% nga privatizimi i ndërmarrjeve që u takon nga marrëdhënia e punës

Luljeta Shehu – Shtroi pyetjet: Cila komunë ka më së shumti ankesa? Sa është numri i ankesave të KK Prizrenit ? Nga cilat institucione arrijnë ankesat?

Naim Rrustemi – I kërkoi Komisionit që rekomandimet të jenë konkrete dhe të fokusuara në këtë çështje, ndërsa për vendimet e plotfuqishme të KPMK-së, nuk ka të drejtë të merret me to as Gjykata Supreme. Nga Komisioni kërkoi të propozonte që Këshilli dhe administrata e tij të vendosen si organ i Kuvendit.

Nerxhivane Dauti - Raportin e vlerësoi lart dhe tha se tani e kemi një pasqyrë të qartë dhe kërkoi nga KPMK-ja, që raportin t’ia procedojë Kuvendit të Kosovës. E mirëpriti përgjigjen e Bajram Azemit dhe Halim Kuliqit për pyetjet e shtruar.

Pas një diskutimi konstruktiv që u zhvillua nga të pranishmit doli konstatim i përgjithshëm për ta gjetur mënyrën si të bëhen efikase dhe të zbatueshme vendimet e KPMK-së. Me qëllim që ta mbështesin punën e Këshillit, kryetari i paraqiti këto:

REKOMANDIME

- Kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës që t’i zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
- Komisioni i kërkon KPMK-së që t’i dërgojë raport Kuvendit të Kosovës dhe në bazë të tij të kërkohet që në njërën nga seancat plenare të zhvillohet debat,
- Komisioni kërkon nga KPMK listën e institucioneve që nuk i zbatojnë vendimet e këtij këshilli,
- Komisioni konsideron se largimi nga puna me skadimin e kontratës së shërbyeseve civilë, nuk është arsye e mjaftueshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës,
- Komisioni i rekomandon Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës të mos shqyrtohen ankesat e organit punëdhënës,
- Komisioni i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të përshpejtohet procedura e procedimit të Projektligjit për shërbyesit civilë.

2. Shqyrtimi i ankesave (peticioneve),

Nerxhivane Dauti – Në cilësinë e raportueses, ka shqyrtuar disa ankesa dhe e ka njoftuar Komisionin për përmbajtjen e tyre. Për secilën ofroi zgjidhje, si vijon:

-Ankesa pa nr. e datës 23. 06. 2009, me të cilën kërkohet qasje e barabartë në media publike, si për komunitetet e tjera që jetojnë në Kosovë.

Komisioni i rekomandon Kryesisë së Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës, t'i drejtohet Bordit të Komisionit të Pavarur për Media dhe të kërkojë trajtim të barabartë në lirinë e shprehjes në mediat publike.

-Ankesa nr. 405 e datës 23. 6. 2009, është kërkuar të zbatohet vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Komisioni i rekomandon që sërish t'i drejtohet Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë në Prishtinë, për zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

-Peticioni p. nr. i datës 17. 4. 2009, me të cilin kërkohet, që njehsorët elektrikë digjitalë ta regjistrojnë rrymën e harxhuar me tarifë të ulët, sikur njehsorët jodigjitalë.

Komisioni konsideron se çështje e ngritur nuk bie në fushëveprimin e tij dhe rekomandon që të kërkojnë nga Zyra për Distribucionin dhe nga Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve përshpejtimin e shqyrtimit të peticionit.

-Në peticionin nr. 02-07-3222 të datës 15. 06. 2009, është shprehur pakënaqësi për zbatimin e decentralizimit në komunën e Vitisë. Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj u rekomandon degëve të partive politike të KK Viti, t'i drejtohen Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

-Në peticionin pa nr. të datës 4. 06. 2009, me të cilin theksohet se pronari T. Sh, u shkaktonte dëme në pasuritë e paluajtshme. Komisioni konstaton se çështja e ngritur nuk bie në fushëveprimin e tij, por kjo rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 2009/03-L-25. Prandaj u rekomandon t'i drejtohen Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor.

-Ankesa e R. S. nga Gjilani, ka kërkuar që emrin e të vëllait të zhdukur ta publikojë në Interpol. Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Ramiz Spahiut dhe i rekomandoi që për publikimin e emrit të vëllait të tij të zhdukur, t'i drejtohet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri